

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË V..., **Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me procesmbajtësen Fatmire Sermaxhaj, në lëndën penale kundër të pandehurit V.S..., nga fshati S... me vendbanim në V..., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1770/2022, të datës 10.10.2022, dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor PP.II.nr.1770/2022, të datës 10.10.2022, më datë 16.08.2023, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit: **V.S...**, i lindur më datë 03.02.1977, në fshatin S..., me vendbanim në V..., me numër personal ...,ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, bujk, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse me datë 23.05.2022, rreth orës 15:15 min, në territorin e fshatit S..., Komuna e V...,së, në vendin e quajtur "Rruga e Samakove", i pandehuri, ka vjedhë drunj në pyllin në pronësi shtetërore, e administruar nga Autoriteti Pyjor Komunal në V..., me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që i njëjti, ka prerë 20 copë drunjë të llojit „Ahu, Bung dhe Shkozë,, me diametër në cung 15.20 cm, në lartësi të drurit 17.5 m, me vëllim gjithsej 2.40 m³, të cilat i pandehuri i kishte pasur të ngarkuar dhe në këtë mënyrë Autoritetit Pyjor Komunal në V..., i ka shkaktuar dëm në vlerë 315 €.

-Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit, nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70, 71, 72 të KPRK-s, si dhe nenit 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

I. Të pandehurit **V.S...**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

II. Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

III. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

IV. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit V.S...nga fshati S... , me vendbanim në V..., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit, nga neni 349 par. 1 të KPRK-ës. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënimi me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënjën e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit V.S..., dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënjën e urdhrit ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet nga provat materiale siç janë: fletëparaqitja për dëmtimin e pyllit shtetëror me vlerësimin dhe llogaritjen e dëmit në pyll me nr.70/2022 e datës 27.05.2022 e ushtruar nga Autoriteti Pyjor Komunal në V..., fletëparaqitja e rojës së pyllit N.H... 70 me numër të ditarit të rojës së pyllit 2/3-22 e datës 23.05.2022, gjyqtari konstatoi se i pandehuri V.S... nga fshati S..., me vendbanim në V..., ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit , nga neni 349 par 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënimi me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimin me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimin, nga neni 38 të KPRK-s.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP-s, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

DEGA NË V...,

P.nr.485/2022, Më 16.08.2023

**Procesmbajtësja
Fatmire Sermaxhaj**

**Gjyqtari,
Behar Ymeri d.v**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.